

## FFK fillon projektin "Futbolli në shkolla"

Një ndër pikat e strategjisë së Federatës së Futbollit të Kosovës është edhe masivizimi i futbollit. Në kuadër të kësaj strategjie nëpërmjet programit Grassroots dhe në bashkëpunim me institucionet arsimore të vendit, FFK ka filluar të zbatojë projektin e futbollit në shkollat fillore. Sot është mbajtur aktiviteti i parë në shkollën fillore "Skënderbeu" në fshatin Perlepnice të Gjilanit, me klasat e treta, të moshës 9-10 vjeç për djem dhe vajza.

Presidenti Agim Ademi e ka vlerësuar fillimin e këtij projekti si shumë të rëndësishëm, pasi qëllimi i tij është shtrirja e futbollit në çdo cep të vendit dhe zbulimi i talentëve qysh në moshën e re.

"Jam i lumtur që kemi filluar me këtë projekt, pasi nëpërmjet tij kemi arritur ta përfshijmë futbollin nëpër shkollat tona. Ky projekt është pjesë e programit "Grassroots", të udhëhequr nga Sanije Krasniqi, e ku bashkëpunojnë trajnerët dhe instruktorët e regjioneve së bashku me mësuesit e edukatës fizike nëpër shkolla. Ky është një projekt ambicioz që synon zhvillimin dhe masivizimin e futbollit që nga nxënësit e shkollave fillore. Me këtë projekt do të japim mundësi të barabartë të gjithë fëmijëve për ta treguar talentin e tyre, në mënyrë që në të ardhmen ta ndjekin ëndrrën e tyre", ka theksuar presidenti Ademi.

Ndërkaq, udhëheqësja e këtij projekti, Sanije Krasniqi ka thënë se nëpërmjet këtyre aktiviteteve po e ndihmojnë masivizimin e futbollit, duke bashkëpunuar ngushtë me shkollat fillore, mësuesit, klubet dhe trajnerët e futbollit.

"Nëpërmjet këtij projekti po ua hapim rrugën fëmijëve që të merren me futboll dhe në të ardhmen të jenë pjesë e klubeve në regjionet e tyre. Është vërtetë kënaqësi kur i sheh fëmijët se me sa shumë dashuri e kanë prituri këtë projekt dhe entuziazmin që kanë për futbollin, prandaj është obligim i yni që të kushtojmë sa më shumë vëmendje të gjithë të përfshirëve në këtë projekt", ka thënë Krasniqi.

Ky projekt do të realizohet në shkollat fillore të të gjitha regjioneve.